



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM
Nr 28 date 23.12.2005

Per

Disa Vleresime dhe Rekomandime te Autoritetit te Konkurrences mbi situaten aktuale te Tregut te Sigurimeve

Bazuar ne nenin 24 te Ligjit 9121, dt 28.07.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences" Komisioni i Konkurrence mori ne shyrtrim Raportin "Mbi Tregun e Sigurimit " te pergatitur nga Sekretariati i Konkurrences dhe paraqitur prej Sekretares se Pergjithshem. Nga vezhgimi i ketij Raporti Komisioni i Konkurrences

KONSTATOI:

-Shkak per ndermarrjen e ketij Studimi ka sherbyer "Marrveshja mbi Pool-in e sigurimit kufitar te pergjegjesive ndaj paleve te treta te mbajtesve te mjeteve motorike", e dates 05.04.2005, lidhur ndermjet 8(tete) Shoqerive te Sigurimit.

-SE nga informacioni i siguruara nga Autoriteti i Konkurrences rezulton se tregu i sigurimeve eshte i hapur per konkurrence dhe nuk karakterizohet nnga situata perqendrimi. Megjithate ky treg nuk eshte plotesisht i liberalizuar, pasi shteti ruan ende kontrollin mbi çmimet, por vetm mbi sigurimin e detyrueshem motorrik, sikurse eshte dhe pergjegjesia ndaj palev te treta (TPL) per perdoruesit e mjeteve motorrike. Nga aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne ket fushe te ekonomise i jepet e drejta Ministrit t Financave te vendose tarifen e primit te rrezikut per cdo kategori mjetesh motorrike. Kesaj vlere i shtohen shpenzimet administrative dhe TVSH-ja dhe vlera (çmimi) pefundimtar mbikqyret nga Autoriteti i Mbikqyrjes se Sigurimeve.

-Se per i takon sherbimit te polices se sigurimit ai eshte i perqendruar ne juridiksioni e Byrose Shqiptare te Sigurimeve dhe percaktimi i tyre me Urdher te Ministrit te Financave mund te konsiderohet si nje nderhyrje me pasoja kufizuese per konkurrencen.

PER KETE ARSYE:

Ne mbestjette te neneve 24, germa d dhe f , dhe 41 te Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences" Komisioni i Konkurrences me propozim te Sekretares se Pergjithshme,

VENDOSI:

I Te miratoje ne parim vleresimet dhe rekomandimet mbi Tregun e Sigurimeve, sipas Relacionit “Disa Vlersime dhe Rekomandime te Autoritetit te Konkurrences mbi Situaten aktuale te Tregut te Sigurimeve “bashkelidhur ketij vendimi dhe konkretisht :

1. Ti rekomandoje Ministrit te Financave qe ne Urdhrin nr. 14. date 06.05.2005 “Mbi Shitjen dhe Administrimin e Policave te Sigurimit Kufitar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit “ te shfuqizoje pikat 1 dhe 2 lidhur me “Prodhimin , Shitjen dhe Administrimin” e Polices se Sigurimit Kufitar, si dhe piken 16 “Per shperndarjen e te ardhurave nga shitja e Polices se Sigurimit.....,”mbasi eshte ne kundërshtim me piken 1, germa a, te nenit 4 te Ligjit nr.9121, date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences”

2. Ti rekomandoje Byrose Shqiptare te Sigurimeve:

-a. Nderprejten e menjehershme te Marrveshjes “Mbi Pool-in e Sigurimit Kufitar te pergjegjesive ndaj Paleve te Treta te mbajtesve te mjeteve motorrike” e dates 05.04.2005 e lidhur mes 8(tete) shoqerive te sigurimit, per arsye se bie ndesh me nenin 4 te Ligjit 9121, date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences”

-b. Heqjen e se drejtes se administrimit te polices kufitare, per te njejten arsye me germen a te kesaj pike.

-c. Qe Polica e Sigurimit te shtypet me logon e çdo operatori.

-d. Qe te gjitha shoqerite e sigurimit ta ofrojne kete sherbim nepermjet agjenteve te licensuar per kete veprimtari.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Franc Zhupa
(_____)
Anëtar

Raimond Cimbi
(_____)
Anëtar

Teuta Shkenza
(_____)
Anëtar

Z/Kryetar

Prof.Asc.Lush PERPALI